



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 33

Prishtinë, më 17.3.2016, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

i mbledhjes së Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaqi, Alma Lama dhe Jelena Bontiq.

Munguan: Shqipe Pantina, Pal Lekaj dhe Zafir Berisha.

Në mbledhje morën pjesë: përfaqësuesit e MAP-së, OSBE-së, BIRN-it, KDI-së, RTK-së, AVONET, Veriu -info, Arbresh - info.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Rishqyrtimi i raporteve të komisioneve të përhershme, lidhur me Projektligjin për procedurën e përgjithshme administrative, nr. 05/L-031;**
- 3. Plotësim-ndryshimi i Ligjit për RTK-në, nr.04/L-046;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Zenun Pajaziti, në fillim të mbledhjes, para se të votohet rendi i ditës, njoftoi anëtarët e Komisionit për disa informacione shtesë, pikërisht për shkresën e EBU-së, adresuar Kryetarit të Kuvendit dhe e posa arritur për Komisionin. Propozoi që pika 3 e rendit të ditës, të hiqet nga

agjenda e mbledhjes, derisa anëtarët e Komisionit të shqyrtojnë shkresën e EBU-së dhe Ministria e Financave të japë versionin përfundimtar lidhur me Ligjin për RTK-në.

Konstatim: Komisioni votoi unanimitisht për heqjen e pikës 3 nga rendi i ditës.

3. Rishqyrtimi i raporteve të komisioneve të përhershme lidhur me Projektligjin për procedurën e përgjithshme administrative, nr. 05/L-031

Sadri Ferati, kryesues i grupit punues për hartimin e amendamenteve të Projektligjit për procedurën e përgjithshme administrative, tha se është punuar gjatë dhe kemi shqyrtuar të gjitha propozimet e dhëna, si dhe ekspertizën e ekspertit të caktuar nga Komisioni, por nëse MAP ka ndonjë propozim shtesë lidhur me vërejtjet e Komisionit parlamentar për Legjislacion, komision kryesor, atëherë të paraqiten në mbledhjen e radhës.

Naser Shamolli, tha se MAP i ka dhënë të gjitha sqarimet rreth vërejtjeve në Komision dhe nuk ka propozime shtesë.

Sadri Ferati, lidhur me përkufizimet, tha se e kemi cekur disa herë edhe në grupet punuese, që përveç në dy raste, nuk ka nevojë për përkufizime, pasi ato janë inkorporuar në nenet përkatëse dhe propozoi që raporti me rekomandime i Komisionit funksional, pas shqyrtimit nga Komisioni për Legjislacion, të votohet dhe të procedohet më tutje.

Konstatim: Komisioni votoi unanimitisht raportin me rekomandime, pa asnjë ndryshim.

Për mbledhjen e radhës u caktua pika e rendit të ditës, plotësim- ndryshimi i Ligjit për RTK-në.

Mbledhja përfundoi në orën: 11:35.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Zenun Pajaziti